



Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova
Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva

KUVENDI

Në bazë të neneve 12.2 shkronja d, 40.2 shkronja a të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale nr.03/L-040, nenit 8 të Udhëzimit Administrativ nr. 01/2015 për Transparencë në Komuna, në zbatim të kreut I dhe II të Ligjit për financat e pushtetit lokal nr.03/L-049, nenin 35 shkronja o, dhe 37 pika 3 të Rregullores së Komunës së Podujevës për mënyrat, procedurat dhe kushtet e pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset e vendimmarrjes nr.01/18-02 të datës 31 janar 2011, dhe nenit 19 shkronja r të Statutit të Komunës, nr.01-1/298-10, Kuvendi i Komunës së Podujevës, në mbledhjen e mbajtur më 28 dhjetor 2016, miratoi këtë;

VENDIM

PËR VËNIEN NË DISKUTIM PUBLIK PROPOZIM RREGULLOREN PËR TAKSA TARIFA DHE GJOBA KOMUNALE

Neni 1

Vihet në diskutim publik:

- Propozim Rregullorja për taksa tarifa dhe gjoba komunale

Neni 2

Diskutimi publik zgjat prej 29 dhjetor 2016 deri më 27 janar 2017 dhe debati me qytetarë mbahet në sallën e mbledhjeve të Kuvendit të Komunës më 20 janar 2017, në orën 10;00.

Neni 3

Vërejtjet, plotësimet dhe sugjerimet paraqiten ditën e mbajtjes të diskutimit publik, gjithashtu në formë të shkruar mund të paraqiten gjatë kohëzgjatjes së diskutimit publik në Zyrën për Marrëdhënie me Publikun dhe Informim, ndërtesa e Komunës zyra nr.32, ndërsa në formë elektronike mund të dërgohen në e-mail adresën; bujar.gimolli@rks-gov.net

Neni 4

Propozimi Rregullores për taksa, tarifa dhe gjoba komunale, sipas nenit 1 të këtij vendimi, publikohet në Web faqen zyrtare të Komunës <http://kk.rks-gov.net/podujeve>.

Neni 5

Diskutimin publik e zbaton Grupi punues, i ngritur nga Kryetari i Komunës, për përgatitjen e propozimit për ndryshimet dhe plotësimet e Rregullores përkatëse bashkëpunim i cili është i obliguar që për Kuvend të përgatit Raportin për zbatimin e diskutimit publik mbi bazën e propozimeve, vërejtjeve dhe sugjerimeve të dhëna në aktin e propozuar dhe të japin sqarime për arsyeshmërinë e pranimit apo mospranimit të propozimeve dhe sugjerimeve konkrete.

Neni 6

Vendimi hynë në fuqi pas vlerësimit të ligjshmërisë përkatësisht regjistrimit në Zyrën e protokollit të Ministrisë së Administrimit të Pushtetit Lokal dhe publikimit në Web faqen zyrtare të Komunës.

Nr. 01-006-93384
Podujevë,
28 dhjetor 2016



Kryesuesi i Kuvendit
Mehmet Gashi